

4 qershor 2026,
Prishtinë

Bazuar në Rregulloren Disiplinore të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) të datës 30.08.2023, si dhe në trajtim të kërkesës për inicim të procedurës disiplinore të datës 25.05.2026, Komisioni Disiplinor i FBK-së (“KD”), me datë 04.06.2026 merr këtë:

V E N D I M

- I. SHQIPTOHET masa disiplinore VËREJTJE (PUBLIKE) ndaj z. Arbër Elshani (Drejtor Gjeneral i KB Peja), në përputhje me nenin 15 të Rregullores Disiplinore të FBK-së;
- II. Masa shqiptohet me qëllim edukues, parandalues dhe korrigjues, në përputhje me nenin 13 të Rregullores Disiplinore të FBK-së, duke synuar mbrojtjen e interesit të përgjithshëm dhe vlerave të sportit të basketbollit;
- III. Komisioni tërheq vëmendjen se çdo përsëritje e sjelljeve të ngjashme në të ardhmen do të konsiderohet rrethanë rënduese dhe do të rezultojë në shqiptimin e masave më të ashpra disiplinore në përputhje me Rregulloren Disiplinore të FBK-së;
- IV. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Më datë 25.05.2026, Komisioni Disiplinor i FBK-së (“KD”), përmes postës elektronike, ka pranuar kërkesën për inicim të procedurës disiplinore ndaj z. Arbër Elshani, Drejtor Gjeneral i KB Peja (tash e tutje “Kërkesa”), lidhur me postimin e datës 25 maj 2026, të publikuar në rrjetin social të tij Facebook.

Në përputhje me aktet në fuqi, KD ka autorizuar administratën e FBK-së që, në bazë të nenit 38 të Rregullores Disiplinore të FBK-së (“RRD”), të kërkojë deklaratë me shkrim nga Klubi lidhur me rrethanat e rastit.

Më datë 02.06.2026, KD ka mbajtur mbledhjen shqyrtuese të rastit. Materialet, provat dhe dokumentacioni relevant kanë qenë paraprakisht në dispozicion të Komisionit, përfshirë postimin përkatës, deklaratën e z. Elshani, informacionet e paraqitura nga administrata e FBK-së dhe rrethanat faktike që ndërlidhen me rastin.

Në funksion të trajtimit të lëndës, KD ka analizuar të gjitha dokumentet dhe provat në dispozicion, si dhe bazën përkatëse ligjore dhe rregullative, dhe ka konstatuar si në dispozitiv për arsyet e mëposhtme.

Gjatë shqyrtimit të rastit, Komisioni mori parasysh faktin se postimi në fjalë ishte publikuar pas transmetimit të një episodi të podcastit “1me1”, duke krijuar një lidhje të qartë kohore dhe kontekstuale ndërmjet përmbajtjes së episodit dhe reagimit publik.

Komisioni kupton se në postimin e publikuar nuk janë përdorur emra të përveçëm dhe nuk ka referenca të drejtpërdrejta ndaj ndonjë personi të caktuar. Po ashtu, nga përmbajtja e postimit nuk rezulton ndonjë thirrje për diskriminim, urrejtje apo dhunë.

Në të njëjtën kohë, Komisioni thekson se Personi ushtron funksion drejtues në basketboll, respektivisht pozitën e Drejtorit Gjeneral të një klubi që garon në nivelin më të lartë të basketbollit në Kosovë, çka bart një përgjegjësi të shtuar për mënyrën e komunikimit publik dhe për respektimin e standardeve të sjelljes që priten nga zyrtarët e basketbollit. Komisioni vlerëson se përmbajtja dhe mënyra e komunikimit e përdorur në rastin konkret janë të papërshtatshme dhe nuk janë në përputhje të plotë me frymën e respektit, profesionalizmit dhe integritetit që duhet të karakterizojë akterët e basketbollit. Për këtë arsye, KD konsideron se reagimi disiplinor është i nevojshëm, me qëllim ruajtjen e vlerave të sportit dhe promovimin e standardeve të duhura të sjelljes publike.

Komisioni shqyrtoi nenin 15 të RRD, i cili përcakton:

Vërejtja shqiptohet për shkeljen e kryer në rrethana lehtësuese, për të cilën parashihet dënimi me ndalesë loje ose kryerjes së detyrës në numër të caktuar të ndeshjeve, kurse organi procedural do ta vlerësoj se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit.

Gjithashtu, KD shqyrtoi nenin 13 të RRD, sipas të cilit:

Dënimet kanë karakter edukues, parandalues dhe korigjues, dhe shqiptimi i tyre do të ketë gjithmonë qëllimin e mbrojtjes së interesit të përgjithshëm dhe vlerave të sportit të basketbollit.


Duke marrë parasysh të gjitha rrethanat konkrete të rastit dhe duke zbatuar parimin e proporcionalitetit, KD vlerëson se masa e vërejtjes është masa më e përshtatshme dhe e mjaftueshme për arritjen e qëllimit të procedurës disiplinore në këtë rast.

KD thekson se kjo masë nuk ka karakter vetëm ndëshkues, por mbi të gjitha edukues dhe parandalues. Komisioni konsideron se përmes kësaj mase arrihet mbrojtja e interesit të përgjithshëm dhe e vlerave të basketbollit, duke i bërë të qartë Personit se standardet e komunikimit publik duhet të respektohen në çdo kohë.

Njëkohësisht, KD nënvizon se çdo rast i ngjashëm në të ardhmen do të vlerësohet me rigorozitet më të lartë dhe mund të rezultojë në shqiptimin e masave më të ashpra disiplinore sipas dispozitave të Rregullores Disiplinore.

Bazuar në të gjitha si më sipër, Komisioni Disiplinor vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni Disiplinor:



Afrim Kamishi
Anëtar



Omer Daku
Kryetar



Blerim Vuniqi
Anëtar

Prishtinë, 4 qershor 2026

Vendimi i dërgohet:

- z. Arbër Elshani
- KB Peja
- Arkivit të FBK-së



Këshilla Juridike:

Kundër vendimit të Komisionit Disiplinor të shkallës së parë mund të parashtrohet ankesë në afat prej 3 ditë (pune), duke llogaritur nga dita e përcjelljes së vendimit përmes postës elektronike, kurse i paraqitet Komisionit të Ankesave dhe Arbitrazhit. Me rastin e paraqitjes së ankesës, paraqitësi duhet të paguaj në llogari të FBK taksën prej 300€, mjete të cilat i kthehen paraqitësit nëse i miratohet ankesa.